

VENDIM
Nr. 186, datë 23.11.2016

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “LUÇENTE KONÇESIONARE” SHPK, PËR
LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC “SPATHARË”, ME FUQI TË INSTALUAR 1038 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2, germa “d”, nenit 41, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 21 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; neni 4, pika 1, germa “a”; neni 5, pika 1, germa “a” dhe neni 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Luçente Konçesionare” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

- Në bazë të nenit 8 të Marrëveshjes Konçesionare datë 2.5.2013, në cilësinë e Konçesionarit së bashku shoqëria “Luçente” sh.p.k. dhe shoqëria “Loshi BL” sh.p.k. duhet që brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i Marrëveshjes të krijojnë shoqërinë konçesionare dhe të bëjnë regjistrimet e nevojshme për të lejuar këtë shoqëri të zhvillojë veprimtarinë e saj.

- Shoqëria “Luçente Konçesionare” e cila ka aplikuar për t’u licencuar në ERE. nuk rezulton të jetë krijuar nga bashkimi i dy shoqërive konçesionare “Luçente” sh.p.k. dhe “Loshi BL” sh.p.k.

- Nga aplikimi i shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k, rezulton edhe mungesa e dokumentacionit si më poshtë:

- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.);

- Neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna specifike për HEC-in);

- Neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin);

- Në korrespondencë zyrtare me ERE-n, shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k., i është bërë kërkesë e përsëritur për plotësimin e dokumentacionit të munguar;

- Shoqëria “Luçente Konçesionare” sh.p.k., nuk ka kthyer përgjigje e as ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për fillimin e procedurave për licencimin në aktivitetin e prodhimit të kësaj shoqërie.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Spatharë”, me fuqi të instaluar 1038 KW.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti